

20090050116

L I G J
PËR NGARKIMIN ME HUA TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA
EVROPIANE PËR NDËRTIM DHE ZHVILLIM SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA
NDAJ PROJEKTIT PËR PËRMIRËSIMIN E RRJETIT EKZISTUES RRUGOR
RAJONAL DHE KOMUNAL

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet te Banka Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim me hua në shumë prej 50 000 000 euro, të dedikuar për realizimin e Projektit për përmirësimin e rrjetit ekzistues rrugor rajonal dhe komunal.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga paragrafi 1 i këtij neni, përcaktohen me Marrëveshjen për hua për Projektin për përmirësimin e rrjetit ekzistues rrugor rajonal dhe komunal, e cila do të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vjet, me periudhë grejs të përfshirë prej katër vjetësh.

Shkalla e kamatës vjetore është shkalla e kamatës variabile EURIOBOR e zmadhuar për 0,50 %.

Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm në shumë prej 0,50% të shumës së huas.

Ndaj shumës së mjeteve të patërhequra të huas paguhet provizion Bankës Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim në shumë prej 0,25% nga shuma e huas në nivel vjetor.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji është Agjencia e rrugëve shtetërore.

Neni 5

Republika e Maqedonisë, huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".